

AKT THEMELIMI
i shoqërisë "Checkin" Sh.p.k.

Sot, me datë 13/05/2022,

- **Znj. Anisa Veliterna**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 26/02/1984, banues në Tiranë, mbajtës i ID me nr. 036693397 me nr. personal. I45226065K, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Checkin" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1
EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "Checkin" Sh.p.k.

NENI 2
SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Mihal Grameno" , Kompleksi Mangalem 21 Kulla 15 , Kati 7 , Ap 1572, Tirane

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4
OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Tregti nepermjet internetit (e-commerce), shitje nepermjet internetit online tek konsumatori dhe nga biznesi tek konsumatori, faqe interneti per pazar (shopping),



Import i artikujve te ndryshem industrial , blerje dhe shitje e artikujve te ndryshme dhe sherbimeve per perdorues ne rrjet (online) ne Shqiperi.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 500.000 (pese qind mije) Lekë dhe është i ndarë në 1 kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Znj. Anisa Veliterna**, zotëron 1(nje) kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 500.000 (pese qind mije) Lekë dhe (500,000) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Znj. Anisa Veliterna, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 26/02/1984, banues në Tiranë, mbajtës i ID me nr. 036693397 me nr. personal. I45226065K, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, , zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pese) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8



DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.
Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë,
duke autorizuar **Administratorin Znj. Anisa Veliterna** për të kryer të gjitha veprimet e
nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në
Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

Anisa Veliterna

Anisa Veliterna

Anisa